


REVISTA  
HÆMUS



HAEMUS  
26-27/2006

apparteneva ad altri. Ho evitato di perseguire qualcuno intorno a me o di bloccare la promozione di chi ne aveva diritto. Sono riuscito a salvarmi dal desiderio di gloria fin da quando ero giovane e non ho preso quel che è di altri (eccezion fatta per alcuni libri che ho preso e non restituito).

Credo che ognuno tra noi vorrà prendere il libro intitolato «La legge in transizione», per non restituirlo mai!

Affermo che per me è stato un piacere ed un privilegio tradurre questo libro dal romeno in italiano, considerando che si tratta non soltanto di un lavoro di giurisprudenza per eccellenza, ma anche di uno sguardo a grandi linee di tutto ciò si è accaduto in Romania nel corso degli ultimi quindici anni, o meglio dire di un'analisi a freddo della storia post-rivoluzionaria di questo paese.

## GJEKË MARINAJ

### *Protonizmi si epiqëndër e veprës “Libra dhe mbresa” të Shefqet Dibranit*

*Shefqet Dibrani ka qenë njeri prej atyre kritikëve bashkëkohor letrar që më ka frymëzuar të mendoj për një emër dhe ta promovoj atë për në një lëvizje letrare që do të njihej nga institucionet botërore të letërsisë zyrtarisht. Protonism (në shqip “Protonizëm”) është emri që kam propozuar për miratim në Konferencën e Profesorëve të Letërsisë Botërore në Des Moines, Iowa, në dhjetor të vitit 2005 për këtë lloj këndvështrimi kritik.*

Libri i sapodalë nga shtypi titulluar "Libra dhe Mbresa" shpaloj një dimension që nuk e kemi parë më parë në potencialin krijues të Shefqet Dibranit. Nisur nga përshkrimi që ai i bën së bukurës në këtë libër, nga logjika që ai aplikon gjatë vlerësimit të mendjeve të holla, apo nga perceptimi analitik që ai u bën veprave letrare të kolegëve të tij, mund të themi me plot gojë se Shefqet Dibrani të bind se është një kritik i denjë letrar.

Kjo është e mundur ngaqë Dibrani ka avancuar me kohën, është formuar si njeri, sofistikuar si poet, kalitur si gazetar, dhe se ka guxuar të hyj më me gjoks se të tjerët në tunelin e mjegullt të kritikës letrare shqipe. Pjekura e gjithanshme që ai ka fituar këtë dekadën e fundit është evidente kudo në faqe të librit "Libra dhe Mbresa." Ndërkohë që edhe kritikët më me përvojë pohojnë se natyra e vështirë e punës se tyre ndikon ndjeshëm në numrin e projekteve që ata marrin për sipër, Shefqet Dibrani shfaqet nga askund dhe me shkathësinë dhe elegancën që tregon gjatë punës me librat, e bën rolin e kritikut letrar të duket një gjë e lehtë për t'u realizuar. Dibrani e bën këtë pa

u merakosur se kush është autori i librit që ka nëpër duar, le të jetë Ismail Kadare apo një emër që nuk e kemi dëgjuar kurrë më parë. Sekretin është se ai përqendrohet në veprat e autorëve dhe jo në emrat e tyre.

Universi analitik letrar i Shefqet Dibranit në këtë libër, për fatin e tij të mirë dhe të letërsisë për të cilën ai shkruan, nuk është i kontaminuar me parazitët falsë-teorik që i kanë krijuar kolonitë e veta mu në zemër të kritikës se sotme letrare në Shqipëri, Kosovë e Diasporë. Ai shkruan i ndërgjegjshëm për ndryshimin midis vlerave relative dhe absolute të librave që i bien në duar, por gjithmonë gjen diçka pozitive për të thënë. Nëse ndonjë libri i mungojnë tërësisht vlerat letrare, ai falënderon autorin për dhuratën dhe e le atë mënjane, pa kërkuar ndihmë tek filozofia që diskriminon dualizmin nga pluralizmi.

Me fjalë të tjera, ai nuk zihet ngushtë apo detyrohet të huazoi, kot së koti, fjalë apo fjali nga fjalorët teorik të letërsisë, dhe pa asnjë lidhje as logjike as letrare të filloi të komentoji me falsitet mbi librat. Dibrani nuk e bën këtë sepse ai nuk ka as deficite kulturore në vetvete, as komplekse për t'u paraqitur sa më i pakuptueshëm me shpresën se një "idiot" do e quajnë atë "kritik të zotin". Kësisoj, midis pasurive profesionale të këtij libri, pastërtia e gjuhës dhe sinqeriteti i mendimeve të autorit përbëjnë dy nga pikat më të forta të librit "Libra dhe Mbresa."

Eliminimi i faktorit fals gjatë punës sugjeron se kur Dibrani lexon një libër dhe vendos të shkruaj rreth tij, më parë se të filloi të shkruaj në fletën e bardhë ai e ka krijuar atë lidhjen e brendshme me veprën në fjalë, e ka ndjerë nevojën për të thënë diçka rreth tij, dhe është gati për t'u bërë ndërmjetës midis librit dhe lexuesit. Ndër këto kushte, kritika letrare e prodhuar nga Dibrani duket se është pjesë e qëllimit të tij për të justifikuar e mbështetur plotësisht autoritetin e tij profesional.

Një punë kaq e vyer dhe kaq voluminoze nuk do të arrihej kurrë me pretendime apo shpresa të rreme. Idetë dhe materialet që ai ka kompozuar në këtë libër janë djersë e një pune këmbëngulëse më se 15-vjeçare. Ato janë pjesë e dashurisë së tij për letërsinë, shkrimtarët dhe lexuesit shqiptar. Ato janë pjesë e karakterit të tij-kur dikush ja dhuron një libër Shefqet Dibranit, ai nuk e vë në raft pa e lexuar fare, por e studion atë, e vlerëson atë, shkruan për të. Asnjë autor shqiptar (që di unë) nuk ka punuar më me shpirt se Shefqet Dibrani për ta ngritur veten në nivelin profesional që ka dhe për të fituar respektin që gëzon sot midis kolegëve dhe lexuesve të tij. Me këtë libër ai vërteton se letërsia është zanat dhe zanati mësohet po t'i dedikosh shpirtin, kohën dhe vëmendjen e duhur.

Nëse përpiqemi të shpjegojmë se ku i ka pikat nxitëse literatura e prodhuar nga cilido poet a shkrimtar që është përfshirë në veprën "Libra dhe Mbresa," e pastaj të tentojmë të arsyetojmë rreth atij fenomeni të çuditshëm që në të njëjtën kohë e ka nxitur Dibrantin të shkruaj rreth tyre, mendoj se rezultatet

do të ishin diçka më tepër se një opinion i edukuar. Gjithsesi, pavarësisht nga thellësia e kulturës prej të cilës do të gjenerohej përgjigjja, ajo nuk do të pranohej kurrë nga të gjithë si një përgjigje plotësisht e saktë. Kjo jo për natyrën abstrakte të temës në fjalë, por më tepër për natyrën e argumenteve që do të shpërthenin, sidomos nga dy grupet ekstreme të gjykuesve. Disa do e miratonin atë vetëm nëse mendimi do të anonte nga ideja se çdo lloj letërsie është e shtyrë tek krijuesi i saj tërësisht nga faktorë krejtësisht të jashtëm, kurse pjesa tjetër e spektrit do të këmbëngulte se çdo gjë që shkruan kritika letrare është e kontrolluar jo nga krijuesi, por nga kritiku që e analizon punën e tij.

U futa në këtë temë jo për të ikur nga analizimi i librit të Dibranit, sepse çdo fjalë e këtij ka për mision nxjerrjen në pah të vlerave të punës së Dibranit, por për të justifikuar, apo marrë në mbrojtje rolin e Dibranit si kritik letrar. Këtë ndërhyrje e ndjej të nevojshme nisur nga fama e keqe që fjala "kritik letrar" ka fituar këto pesëdhjetë vitet e fundit të letërsisë shqipe. Ndonëse kritika letrare e realizmit socialist ka kohë që e ka "thyer qafën" për shqiptarët akoma ekziston një inat i brendshëm ndaj kritikëve. Shpresoj të jemi gabim, por nga bisedat që mbaj me miqtë e mi krijues, akoma për një shkrimtar apo poet, një kritik letrar konsiderohet si dikush që zgjatë kokën nga një qoshe e fshehtë duke përdorur hamendjen se ç'shije kanë ushqimet e shtruara mbi tavolinë. Për një kritik letrar, nga ana tjetër, shkrimtarët dhe poetët janë shpesh si topa plasteline që presin të marrin formën e duhur nga duart e kritikëve, teoricienëve apo akademikëve. Por edhe në këtë pikë, e siguroj lexuesin dhe kolegët se Shefqet Dibrani nuk paraqitet as i akademik, as si teoricien, as si kritik letrar i tipit të realizmit socialist.

Përkundrazi, ai paraqitet thellësisht njeri, intelektual dhe njohës e dashamirës i fjalës së shkruar letrare. Lexon librin dhe menjëherë e kupton se ai gjendet diku midis ekstremeve të mësipërme, i pa mënjeluar as andej as këtej. Në këtë vepër letrare, të cilën me zgjuarsi e ka emërtuar me nëntitullin "Venerime Letrare" (që mesa kuptoj unë është një shprehje lokale që nga kosovarët kuptohet si një vëzhgim i preokupuar në fushën e letërsisë) Dibrani të lë përshtypjen e një kritiku që beson plotësisht në synimet autoriale. Në të njëjtën kohë ai nuk e hedh poshtë as probabilitetin se edhe për atë ekziston mundësia e influencës profesionale nga kultura, edukimi, përvoja e nganjëherë edhe nga paragjykimet e mjedisit ku punon dhe jeton. Por ai nuk ka huazuar asgjë nga kultura letrare e ish komunizmit.

Ky pozicion autorial, pra kjo fizionomi individuale e perceptimit të modelit të ndjekjes së letërsisë me një sy të ri kritik, nuk është i vështir të nuhatet gjatë leximit të 670 faqeve të librit. Në çdo paragraf, në mos asgjë tjetër, duket se tabani filozofik i librit mbështetet mbi idenë se këto recensione letrare janë kompozime shpirtërore aq sa ç'janë edhe prodhime mendore.

Ato janë fryt i futjes dhe i meditimit të gjatë në zemër të çdo libri që Dibrani trajton.

Ndonëse synimi depërtues i autorit në këto faqe është i maskuar nga tentativa për t'u shmangur nga sferat e mekanizmave teorik, ai nuk e fsheh dot dëshirën që libri i tij të mbetet një dritare e varur midis krijueseve dhe lexueseve. Për këtë ai është treguar i kujdesshëm gjatë punës së tij. Në këtë libër, Dibrani tregon se është i informuar mirë rreth analizimit me përkushtim bibliografik të veprave letrare. Pra ai në një farë mënyre e njeh si të arsyeshme dhe me potencial historik idenë e atyre kritikëve letrar që besojnë se shkrimtarët janë shembuj të njerëzve superior, dhe si të këtillë, duke e shpalosur dhe shpjeguar para lexuesit jetën e tyre, përveç se do e bënin më të kuptueshëm atë, nëpërmes këtij kuptimi do të dilte në pah edhe fuqia e tyre individuale prej gjeniu. Megjithëse kritika bibliografike na jep një informacion të vlershëm në lidhje me jetën, veprën dhe rrethanat ndër të cilat projekti është hedhur mbi fletën e bardhë, Dibrani është mjaftuar duke përfitur nga kjo metodë kritike vetëm me dhënien e idesë se e njeh, mund të përdorë me efektivitet atë dhe se i respekton mendimet e paraardhësve të tij që i kushtuan një jetë të tërë kësaj metode analitike. Pavarësisht nga kujdesi për një evitim esencial të kushteve që vë kritika bibliografike, Dibrani nuk ka hezitur t'i aplikoi aftësitë e tij në këtë drejtim, sidomos atë ku e ka parë si të domosdoshme. Shënimet me titull "Tkurrja e Atdheut" , "Është koha të duhemi" dhe "Kuajt," janë vetëm një pjesë e koleksionit ku pozicioni bibliografik përbën epiqendrën e punës së Dibranit në këtë libër.

Kjo nuk do të thotë aspak se jeta e autorëve për të cilët shkruan Dibrani ka mbetur e distancuar nga veprat e tyre. Ndryshimi ka të bëjë me llojin e kritikës letrare. Përkujdesja profesionale e këtij aspekti vihet re në fund të shënimit për çdo libër të trajtuar. Aty gjenden hollësi rreth vendlindjes, shkollimit, veprave letrare, pa lënë pas dore as peripecitë jetësore të disa autorëve, natyrisht ku ato kanë ekzistuar. Dhe kjo punë është bërë me përkushtimin e duhur jo vetëm për autorët, por edhe për emrat e rreth 1250 krijuesve apo personaliteteve, të cilët përbëjnë treguesin e librit "Libra dhe mbresa."

Siç do e shohim edhe më poshtë, Dibrani nuk i fsheh ambiciet e tij për t'u paraqitur para lexuesit jo vetëm si një njeri me cilësi të admirueshme humane, por edhe si një lexues i ndjeshëm dhe i kualifikuar, pena e së cilit nuk ngjyhet asnjëherë në vrer, por në hokën e përpjekjeve për ta ngritur sa më lart punën dhe personalitetin e kolegëve të tij nëpërmes shkrimeve që bën për librat e tyre. Për këtë tip kritike letrare deri vjet nuk kishim emër zyrtar, ndonëse ajo si koncept ka ekzistuar më parë, ndonëse ka filluar të marrë jetë më vullshëm vetëm aty nga vitet 60 të shekullit që kaloi. Shefqet Dibrani ka qenë njeri prej atyre kritikëve bashkëkohor letrar që më ka frymëzuar të mendoj për një emër dhe ta promovoj atë për në një lëvizje

letrare që do të njihej nga institucionet botërore të letërsisë zyrtarisht. Protonism (në shqip "Protonizëm") është emri që kam propozuar për miratim në Konferencën e Profesorëve të Letërsisë Botërore në Des Moines, Iowa, në dhjetor të vitit 2005 për këtë lloj këndvështrimi kritik. Sa relevant është propozimi im në kufijtë e këtij shkrimi? Unë mendoj se është relevant sepse Shefqet Dibrani ka zbatuar më shumë ide të protonizmit se çdo lloj tjetër të kritikës letrare.

Nën ombrellën e protonizmit dhe të shpjegimit se si Dibrani e ka punësuar atë si mekanizëm për t'u dhënë jetë ideve të tij në lidhje me vlerat në letërsi, është me vend të shpjegojmë se jam i ndërgjegjshëm se roli i një kritiku letrar, në krahasim me tërësinë e letërsisë që prodhohet në botë, është po aq i vogël sa ç'është një atom në një element kimik. Pasi kjo u tha, vlen për të shtuar se çdo kritikë letrare në natyrën e vet edhe çdo vepër letrare në universin që bën pjesë, janë respektivisht pjesë e pandashme e fatit të asaj kulture letrare që ne sot e quajmë letërsi.

Parë nga ky kënd, edhe kritika letrare, si fizika, e ka "atomiken" e vet dhe kjo "atomikë" është e pranueshme për sa t'u përmbahet ligjeve përkatëse. Pra rreth bërthamës së letërsisë shqipe, si edhe asaj botërore, kemi parë plot kritikë letrar që sillen tamam si elektrone, të predispozuar të përçojnë gjithë jetën vetëm energji negative. Ata shpesh janë të zymtë nga pozicioni që gëzojnë profesionalisht, nga shijet që kanë për artin dhe fjalën e shkruar artistike, vuajnë shpirtërisht ngaqë ndërgjegjen nuk e kanë kurrë të qetë, dhe më e keqja, në syrin e shumicës jetojnë nën etiketën e letrarëve të dështuar. Kjo ndodh se kur shkruajnë për një libër, apo komentojnë rreth filanit, jo rreth një autori, ata nuk shkruajnë duke gjykuar veprën e tij, por veten e tyre, smirën që kanë fituar nga sukseset e të tjerëve, dështimet e veta në jetë, e nganjëherë, zbulojnë veten duke u orvatur të tërheqin të tjetër poshtë ngaqë nuk arrijnë dot të ngjiten në nivelin e tyre.

Po kështu të gjithë jemi dëshmitarë të asaj pjese të kritikës që brenda bërthamës letrare vepron me ngadalshmëri pa ndonjë ngarkesë elektrike pozitive apo negative. Ata mundohen të japin e të marrin duke u përpjekur të jenë sa më racionalist. Tradicionalisht këta soj kritikësh kanë mbetur si më të respektuarit. Ata mundohen të gjykojnë sa artin aq edhe autorin. Të zhveshur nga çdo barrierë e jashtme, punojnë me librin duke zgjedhur për lexuesin ato gjëra që ata mendojnë se kanë më vlera, pa lënë pas as mangësitë.

Pastaj kemi Shefqet Dibranët e kritikës letrare që luajnë rolin e një protoni në peshën apo në strukturën "atomike" të një vepre letrare. Pra ata vërshojnë drejt letërsisë me energji pozitive. Për fat të mirë, protonistët veprojnë apo reagojnë drejt letërsisë me ngarkesa të mjaftueshme "elektrike" te karakterit pozitiv sa të mbajnë në ekuilibër apo të barazojnë numrin e "ngarkesave" negative të "elektroneve". Në protonistët, në rastin

tonë në veprën e Shefqet Dibranit, mbizotëron thelbi njerëzor, shpirti human, dëshira për të inkurajuar të tjerët, për të dalluar vetëm të bukurën në gjithçka e në këdo, pra mbizotëron ajo pjesë e shkrimtarit që e ka bërë botën letrare kaq moderne sa ç'e kemi sot.

Kaq njerëzore është përmbledhja “Libra dhe Mbresa,” kaq pozitiv është autori i saj Shefqet Dibrani. Ai ka gjetur diçka të mirë për të thënë për një numër të konsiderueshëm shkrimtarësh e poetësh që jetojnë në Zvicër, për një numër disa herë më të madh krijuesish që jetojnë në mërgim nëpër vendet e tjera të botës, për dhjetëra e dhjetëra personalitete letrare që jetojnë në Shqipëri e Kosovë. Ai ka gjetur mirësi në vetvete për të mbushur më se 650 faqe, pa përsëritur veten, me komente e mendime pozitive për kolegët e tij shqiptar e të huaj.

Siç e përmenda edhe më lart, Shefqet Dibrani në këtë libër nuk paraqitet para lexuesit thjesht si një kritik, por si një kritik letrar i tipit të ri, si një kritik protonist. Kjo jo se ai nuk është në gjendje ta dalloj të mirën prej të keqes në letërsi. Kur ai ka ditur të dalloj të mirën, do të thotë se bagazhi i tij ka njohuri të mjaftueshme për etikën në letërsi. Kur ai ka aftësitë të komentoi me aq pasion e kompetencë për të bukurën, do të thotë se horizonti kulturor i tij i plotëson kërkesat e një gjykuesi të denjë të estetikës letrare. Dibrani e di se jo të gjithë autorët kanë arritur përsosje në krijimtarinë e tyre. Por ai është i vetëdijshëm se koha, talenti, e mbi të gjitha shpirti madhështor i tij si njeri, janë shumë më efektive në kërkim të së bukurës se sa të së shëmtuarës në letërsi.

Në këtë pikë ai do të respektohet jo vetëm nga krijuesit, por edhe nga kritikët, sidomos nga ata kritikë që e gjykojnë letërsinë në aspektin ekokritikal (ecocritical). Ekokritikët i kërkojnë rrënjët e veta jo në momentet politike jashtë sferave të studimit të letërsisë, siç bënin marksistët e nganjëherë feministët, por tek lëvizjet ambientale dhe tek historia e gjatë e letërsisë së shkruar me subjekt kryesor natyrën. Ajo që do të dëshiroja që të mbanin mend lexuesit e këtij shkrimi është fakti se edhe tek natyra, dhe tek njerëzit, pavarësisht nga përzgjedhja e tyre, po të kërkosh në brendësi të tyre do të gjesh si gjëra që mbajnë erë të mirë ashtu edhe gjëra që mbajnë erë të keqe. Shumica e njerëzve do u bashkohen ekokritikëve dhe protonistit Shefqet Dibrani: ata nuk duan të dëgjojnë, fjala vjen, për dushqet e kalbura apo për ferrat në qoshet e fshehta të një parku të bukur, por për gjelbërimin, lulet, frutat, ujin dhe ajrin e pastër që të fal natyra në këtë vend. Është e kuptueshme se çdo krijesë, madje edhe ajo më e rëndësishmja, krijesa njerëzore, e ka pjesën imperfekte të saj. Por Shefqet Dibrani është protonist, dhe si tillë angazhohet vetëm pas të bukurës në letërsi.

\*

**Autori**, vazhdon studimet pasuniversitare, kurse punon në Baylor University Medical Center, Departamenti i Patologjisë, dhe në të njeten kohë ligjërues në

Richland College, ku jep mësim lëndët *English & Communication si dhe Letërsinë Botërore*. Eshtë editori Shtëpisë Botuese "Marinaj Publishing" në Dallas, themelues i Shoqatës së Shkrimtarëve Shqiptaro-Amerikanë, dhe drejtues i revistës "Pena", organ i kësaj shoqate. *Për më shumë informacione rreth autorit vizito faqen personale të internetit: <http://www.marinajpublishing.com/marinaj/>*

## GEORGE-DANIEL CRISTEA

### *Viața și opera lui Konstantinos Kavafis*

#### Introducere

*Monștrii* literari, ca și cei din natură, apar în cele mai neașteptate locuri. De ce ar produce, la urma urmei, Buenos Aires un Borges, Palermo un Lampedusa, Trieste un Svevo? Singurul - și în același timp, perfect nesatisfăcătorul răspuns este – de ce nu! Nimic nu ar fi putut să prevadă transformarea acestora în scriitori universali. Nu există o explicație logică, doar simpla lor apariție, doar ei scriind ca nimeni altul înaintea lor și producând opere de valoare universală. Pentru că au apărut practic de niciunde, nu se poate spune că acești scriitori au început sau au lăsat ceva care să aducă a tradiție. În definitiv, nu asta este un *monstru*? Ceva care, sui generis, este, în sine, o categorie aparte.

Konstantinos Kavafis, poetul grec care a trăit în vechiul oraș egiptean Alexandria, este un alt *monstru* literar, probabil cel mai interesant și de neexplicat dintre toți. Ca și Borges, Lampedusa și Svevo, Kavafis este un poet a cărui viață, ale cărui teme literare și puncte de vedere sunt legate definitiv de orașul său. „Kavafis nu există în afara poemelor sale”, spune poetul și criticul grec Giorgios Seferis. Nici poemele sale nu ar fi existat, însă, fără Alexandria: „pentru mine, tot ceea ce ești tu s-a transformat în sentiment”, scria Kavafis, referindu-se la Alexandria în unul din ultimele sale poeme, intitulat: *În același loc*.

Konstantinos Kavafis a fost cel mai mic dintre cei nouă frați ai familiei. Când s-a născut el, familia lui trecuse deja prin bune și prin rele. Tatăl lui Kavafis era unul dintre negustorii de frunte ai coloniei grecești din Alexandria, în parteneriat cu fratele său iar firma era specializată în comerțul cu bumbac și textile. În această colonie, singurul lucru important era banul, de care familia lui beneficia din plin, așa că micul Konstantinos a fost crescut cu profesor de franceză și bonă englezoaică. Frații mai mari au fost trimiși în străinătate pentru educație. Tatăl, care a risipit banii și a murit când Kavafis avea șapte ani, lăsându-și soția săracă, iar pe fiul său cu



# PENA QË S'U THYEN CONDEIE CARE NU S-AU FRÂNT

---

## DHURATA HAMZAI

### *„Kuajt” dhe arratia e poetit Gjek Marinajt<sup>58</sup>*

Asnjëherë nuk dihet fati i krijuesit dhe i veprës së tij. Dhe poeti Gjekë Marinaj, i arratisur në vitin 1990 nga atdheu drejt Amerikës (para se të rrezohej Komunizmi në Shqipëri), nuk e kishte parashikuar se pikërisht pas 16 vjetësh miqtë e tij do të mblidheshin bashkë dhe do të himnizonin poezinë e tij “Kuajt”, kthyer tashmë në baladë, dhe me këtë rast ata do t'i kthenin atij të gjithë mallin dhe dashurinë e humbur. Por ai nuk ndihet më aq entuziast për këtë poezi, sa për një mision tjetër më të rëndësishëm, për të cilin është kthyer në atdhe. Poeti Gjekë Marinaj, ashtu siç nuk kishte parashikuar as fatin e arratisë, nuk do ta parashikonte dot se një ditë një grup profesorësh amerikanë me të cilët aktualisht punon, do të bëheshin kureshtarë për letërsinë gojore shqiptare, e sidomos për Eposin e Veriut. Tashmë ata kanë nisur një ekspeditë, me të cilën Marinaj do të bashkëpunojë derisa një ditë dëshiron ta shikojë pasurinë kombëtare, padrejtësisht të fshirë nga historia e letërsisë botërore- në faqet e saj. Një poezi gati baladeske e çoi Gjekën në Amerikë, dhe një poezi më e madhe, ajo e popullit të tij e risolli në atdhe. Për arratinë e tij vagullore, në një bisedë ai kujton takimin me Ambasadorin Amerikan në Beograd. Gjeka tha: “unë kam një poezi, që u bë shkak që unë jam sot këtu. –“Këtu në Beograd

---

<sup>58</sup> Gjekë Marinaj u lind në Brrut të Malësisë së Madhe, në vitin 1965. Ai u largua nga Shqipëria për arsye politike në vitin 1990. Është nderuar me disa çmime nacionale (Amerikane) dhe internacionale për krijimtarinë e tij, duke përfshirë The Golden Pen Award (26 nëntor 1999) dhe International Poet of Merit Award (17 nëntor 2002). Ai është autor i dy librave me poezi dhe i një libri intervistash me individualitete të zgjedhura. Marinaj është gjithashtu botues dhe editor aktual i revistës Pena, revistë letrare e Shoqatës së Shkrimtarëve Shqiptaro-Amerikanë. Ai jep mësim English & Communications dhe World Literature në Richland College, në Dallas të Teksasit, ku jeton me gruan e tij, Dusita. Vepra letrare: "Mos më ik larg", 1995 – poezi, "Infinit", 2000 – poezi, "Ana tjetër e pasqyrës", 2003 – intervista, "Ora e paqes", 2005, përkthim - poezi nga Rainer, "Në shpellën e Platonit", përkthime nga Frederick Turner, etj.

e ke?,- tha ambasadori. “-Po, tha Gjeka”. “-Me vete?” Jo,- tha Gjeka, -e kam në Hotel”. “- Atëhere në rregull, -më tha, sille nesër”. Për mua ishte shumë e vështirë të rrija dhe një ditë tjetër vetëm që të çoja atë poezi, rrëfen Gjeka. Shkova ditën tjetër. Ia lexoi përkthyesi dhe ai më tha: “Paç fat në Amerikë, bir!”. Kjo ishte fjala që shoqëroi udhëtimin e Gjekë Marinaj drejt Amerikës... Poezia “Kuajt” u kujtua me rastin e promovimit të përmbledhjes me poezi të zgjedhura nga krijimtaria e poetit të famshëm amerikan Frederick Turner, në Qendrën Ndërkombëtare të Kulturës (QNK). Libri u përkthye në shqip nga Gjekë Marinaj dhe u manifestua me pjesëmarrjen e një numri të konsiderueshëm shkrimtarësh, politikanësh aktivë shqiptar, si dhe të medias shqiptare. Frederick Turner është i njohur si një nga poetët më të rëndësishëm të letërsisë së sotme botërore, kandidat për Çmimin Nobel në letërsi (këtë vit i propozuar nga 41 universitete dhe organizata të akredituara letrare nga e gjithë bota, fitues i çmimit “Pen International,” etj). Ndërsa Gjekë Marinaj aktualisht është presidenti i Shoqatës së Shkrimtarëve Shqiptaro-Amerikanë, poet dhe publicist i mirënjohur, dhe autori i poemës “Kuajt”, e cila ka ndihmuar miqtë e tij në revoltat kundër qeverisë despotike. Mezi u shkëput i gjallë nga Shqipëria, Gjekë Marinaj, më 12 shtator të vitit 1990 dhe është tani shtetas amerikan.

### ***Kuajt***

*Tërë jetën duke vrapuar rrimë  
Shohim veç përpara  
Ç'bëhet prapa s'duam t'ia dimë.  
Ne nuk kemi emër  
Të gjithëve kuaj na thonë.  
Nuk qajmë,  
Nuk qeshim;  
Heshtim,  
Dëgjojmë;  
Hamë atë ç'na japin,  
Ecim nga na thonë,  
Asnjë nga ne s'është mendje hollë.  
Kush qe kalë mbreti,  
Posti qe i lartë  
Kush qe kalë princeshe  
I bënë shalë të artë  
Kush qe kalë fshatari  
Pat samarë me kashtë  
Kush qe kalë i egër  
Tërë jetën fjeti jashtë.*

*Po qemë dhe mbetem kuaj, para njeriut!*

## **Biseda**

**Dhurata Hamzai:** *Zoti Gjekë Marinaj, jeni arratisur nga vendi juaj drejt SHBA-së që në vitin 1990, kur ende Shqipëria ishte nën sundimin komunist. Cilat ishin motivet që ju sollën këto ditë në atdheun tuaj?*

**Gjekë Marinaj:** Sigurisht që ardhja ime këtu do të shoqërohej edhe me vizitën e shkrimtarit të madh amerikan Frederick Turner, i cili për fat të keq, ndërsa bëhej gati të vinte këtu që të ishte i pranishëm në promovimin e librit “Ne shpellën e Platonit”, përkthyer në shqip prej meje, sëmuret dhe shkon në spital për të kryer një operacion. Ju e dëgjuat edhe në letrën e tij që u lexua gjatë promovimit, ku ai duke u kërkuar falje premtonte se do të vinte në Shqipëri, sapo shëndeti i tij të përmirësohej.

*- Kur e përkthyet Frederick Turner, pas 16 vjetëve i larguar nga Shqipëria, a e dinit, ju Gjekë, se këtu në Shqipëri ka poezi të mira, ka shkrimtarë të rinj të mirë, por kritikë letrare pothuajse nuk ka?*

- Ajo më ka shkuar ndërmend, sepse e dija që Shqipëria ka shkrimtarë të mirë, ka plot poetë e shkrimtarë të përkthyer, por e dija se nuk ka Frederick Turner. Unë mendoj se poetët janë si yjet. Secili e ka atë bukurinë e tij në hemisferën e vet dhe unë në fakt mendoj se kam gjetur një nga yjet më të mëdhenj, të cilët kur Shqipëria nuk kishte relacione me botën, ishin në një mjegull, kishte një re midis poetëve si Frederick Turner dhe të tjerëve. Unë mendova se ky është shansi im që t'i largoj këto re. Dhe është mirë që një poet kaq i madh të shihet fytyrë për fytyrë me poetët shqiptarë që kanë një dimension kaq të madh si ky poet dhe një dëshirë po aq të madhe për të lexuar.

*- Një nga mesazhet e Turner për poezinë, ose të Turner “si ruajtës i poezisë”, bie direkt në konflikt me atë lloj poezie të shpikur veç prej mendjes, të asaj poezie që vrapon drejt formave të jashtme, eksperimentimit, etj, si do ta zgjeronit ju komentin rreth këtij mesazhi?*

- Po, mesazhi i tij është që të hidhen sytë nga poezia. Mesazhi i tij është njerëzor. Ai nuk do që ta largoi poetin nga njeriu. Ai ka arritur që ta tërheq poezinë nga poezia mekanike, nga terminologjia e errët. Ai mendon si mund ta bëjmë poezinë pronë të njeriut, poezi të humanëve. Ai e konsideron poezinë si medikament. Njeriut i dhemb shpirti, njeriut i vuan shpirti. Shko

merr Frederik Turner dhe ai të qetëson, sapo e lexon! Lexoje poezinë që ka për dashurinë dhe të bën më të zjarrtë, të bën më erotik. Lexoje poezinë që ka për të kaluarën, të bën ta duash atë e të kesh një farë nderimi dhe në të njëjtën kohë ka një fuqi marramendëse për të ëndërruar të ardhmen, ku përfshihet e ardhmja e njerëzimit dhe e ardhmja e poezisë.

*- Ç'farë keni planifikuar gjatë ditëve që ju do të qëndroni këtu në Shqipëri?*

- Qëllimi i ardhjes sime këtu, nuk është thjesht promovimi i librit, por unë kam ardhur për një punë tjetër këtu. Unë kam ardhur me tetë profesorë amerikanë që do të studiojnë poezinë e Ballkanit, domethënë poezinë epike gojore. Jemi të ndarë në tre grupe. Unë isha bashkë me Turner dhe profesor W. Galatin, por kur Turner nuk erdhi dot, profesor Galati qëndroi në Beograd me grupin tjetër. Ne do të bëjmë së bashku pas kësaj studimin e poezisë epike të Ballkanit. Kështu që unë kam dhe dy ditë të tjera këtu dhe do të shkoj me grupin në Beograd dhe që andej do të shpërndahe mi për në shtetet e tjera të Ballkanit.

*- Zoti Gjekë, ky duket një projekt shumë interesant. Si ka nisur ideja për këtë ekspeditë nga profesorët amerikanë?*

- Për fat të keq, letërsia botërore, lëndë të cilën unë e jap në Amerikë, nuk ka asnjë të dhënë për epikën gojore shqiptare, për eposin, legjendat dhe folklorin shqiptar. Pothuajse poezia epike gojore shqiptare nuk njihet fare në botë sot për sot. Mirëpo poezia gojore e Ballkanit njihet, por vetëm nëpërmes versioneve që kanë bërë serbët, grekët, maqedonasit, etj. Mirëpo unë, përpos që dëgjoja letërsinë epike, sepse është pjesë e punës që bëj, më ra në sy kjo mungesë. Vendosa “ta ngre pak zërin”, dhe kështu që u vendos nga UTD (Universiteti i Teksasit në Dallas) që të sponsorizohet kjo ekspeditë. Është plan që, nëse punët do të na shkojnë mirë, ne do të kemi një tekst të ri shkollor për Universitetet në Amerikë ku epika e Ballkanit të paraqitet sa më të plotë. Përveç poezive të mbledhura, aty do të ketë edhe një studim të përbashkët akademik rreth tyre. Poezitë i duam të jenë sa më të panjohura, të pabotuara, e të paredaktuara që të jetë e mundur. Do të përqendrohemi me shume kujdes edhe në vlerat analitike të projektit. Do të zbulojmë se çfarë ka menduar shqiptari p.sh kur Gjergj Elez Alia dhe Bajlozi i Detit “kanë” luftuar me njëri-tjetrin, se cili ishte koncepti i dashurisë, nderit apo trimërisë në atë kohë. Pse Balozit, fjala vjen, ishte i keq dhe Gjergji ishte i mirë. Pra, përmes artit, duam të futemi në brendësinë ideologjike të popullit në atë kohë, duke menduar se poezia dhe arti i një

kombi është produkt i popullit, sepse populli është ai që ka menduar dhe e ka ruajtur atë poezi.

*- Pra, zoti Gjekë, ky qenka një kthim shumë i bukur në atdheun tuaj, sepse në poezitë tuaja vë re se largimi juaj në Amerikë lidhet me një frikë se mos po humbisni gjithçka, por ju po zbuloni diçka që ka humbur herët me profesorët amerikanë dhe do ta çoni si vlerë në Amerikë, apo jo?*

- Unë shpresoj që vërtetë ta bëjë këtë, sepse ndiej një përgjegjësi shumë të madhe. Unë e kam nisur këtë punë që nga Himara, sepse nuk dua ta ndaj epikën shqiptare duke dhënë mendimin se ajo i përket vetëm e Veriut. Ne jemi një komb relativisht i vogël dhe ata që sot jetojnë në Vlorë kanë shumë gjasa që të jenë nga Veriu dhe në Veri ka gjasa të jetojnë shumë nga ata që janë nga Vlora... Kështu që kam shpenzuar dy ditë atje. Kam takuar fshatarë. Jam takuar me njerëz që i dinin këngët e vjetra epike të Shqipërisë së Veriut. Ata i kanë thënë me shumë dëshirë. Ndjey një përgjegjësi shumë të madhe, sepse që në vitin 1870 ka shqiptarë në Amerikë, por nuk i është dhënë askujt deri më sot një shans i tillë. Unë e kam mundësinë që ta vendos poezinë epike shqiptare krah për krah me atë të vendeve të tjera të Ballkanit, duke e lënë lexuesin e huaj të vendos vetë për klasifikimin e saj. Në të njëjtën kohë, kam besimin se kur ky projekt të jetë i plotësuar, poezia epike shqipe do të renditet me poezinë më të kualifikuar të Ballkanit.

*- Sigurisht që ju duke përmbushur këtë mision, patët rastin edhe të jeni i pranishëm në promovimin e librave tuaj, atij me poezi të përkthyer të Turner dhe përmbledhjes modeste me poezitë tuaja “Infinit”, por ajo që u diskutua me tepër dhe që iu riktheu sërish si emër të njohur në atdhe ishte poezia juaj “Kuajt”...!*

Unë jam munduar që prej vitit kur u largova nga Shqipëria t’u shmangem intervistave për poezinë “Kuajt” dhe në shumicën e rasteve ia kam arritur... Heeh, poezia “Kuajt” ishte një poezi me fat. Natyrisht që nuk është poezia ime më e mirë, por ishte një poezi me shumë fat. U shkrua në një kohë të caktuar e kishte fat sepse doli nga një poet i panjohur, nga “askushi”. Sikur e njëjta poezi të ishte botuar nga poetët e njohur si Kadare, Rudolf Marku, Preç Zogaj, Xhevair Spahiu, etj, nga xhelozia “dikujt” ndoshta nuk do të kishte në fillim të njëjtën jehonë, por duke e ditur se u krijua nga “askush”, ajo u shpërnda me gjithçka pati në vetvete. Sikur një poet bën një poezi dhe humb, unë bëra një poezi dhe fitova... Kështu unë nuk e shoh veten si ndonjë poet të jashtëzakonshëm, në qoftë se njerëzit më identifikojnë mua me poezinë “Kuajt”, por më vjen mirë që unë munda të nxjerr diçka nga jeta

e përditshme dhe ta vë në vargje, duke u dhanë njerëzve për të kuptuar se shqiptarët po vuanin, se shqiptarët po hanë ç'u jepnin dhe se shqiptarët kishin mbi krye ashtu siç kanë gomerët dhe kuajt njerëz që aq ishin. Mesazhi i fundit që shqiptarët nuk ishin kafshë, por “ne qemë dhe mbetëm kuaj para njeriut”, pra, kuptuar nga mënyra se si komunizmi i formonte njerëzit në çfarëdo mirëqenie që të jenë, ishte se ata mbetën kuaj para njeriut. Por komunistët e interpretuan ndryshe. Megjithatë edhe interpretimi i dytë edhe pse nuk ishte i thënë me qëllim, edhe ai interpretim ka shërbyer mirë.

- *Ku u lind Gjekë Marinaj?*

- U linda në Brrut të Malësisë së Madhe. Brruti është një fshat i vogël me 5 shtëpi. Ndonëse Brruti është shumë poetik për mua, poezinë nuk e kam filluar aty. Në fakt, në atë kohë s'e kuptoja poezinë pothuajse fare. Vetëm kur kam shkuar në Bajzë, në moshën 13-14 vjeç kam filluar të shkruaj.

- *Ideja juaj për të shkruar ka nisur nga ndikimi i leximeve, apo ju kishit një ndjesi të jehonës së këngëve dhe baladave popullore të trevës ku banonit?*

- Kam filluar të shkruaj jo se poezia ishte e rëndësishme, por se besoja se poeti ishte i rëndësishëm. Për mua kur flitej se dikush ishte poet, më dukej se fjala “poet” kishte diçka magjike në vetvete. Madje, më duket se edhe sot ky imazh nuk ka ndryshuar rrënjësisht, se pa poetët nuk do të kishim poezi. Kur dëgjoja për poetët, më dukej se flitej për diçka që krijonte një lidhje të çuditshme midis njeriut dhe Zotit. Unë nuk arrija ta kuptoja se si njerëzit, kushdo që ishin - intelektualë apo njerëz të thjeshtë, nuk përpiqeshin që secili prej tyre të luftonte që patjetër të bëhej një poet i madh. Për mua poetët ishin shkalla e lartë e qenies njerëzore. Për disa poetë edhe sot e kësaj dite mendoj të njëjtën gjë. Por tani jam i ndërgjegjshëm se poezia është si një ylber, sa do që të duket se po i afrosh aq më të vështirë e ke ta zotërosh plotësisht atë.

- *Sigurisht që historia e arratisë suaj të bën shumë kureshtar. A mund të na tregoni diçka rreth asaj ngjarjeje, e cila ishte e ndëshkueshme në sistemin totalitar?*

- Po, poezia “Kuajt” u bë shkak. Unë mora lajmin se do të shkoja dhe do të takohesha në Degë të Brendshme, të nesërmen në orën 8.00 të datës 12 shtator, dhe të them të drejtën u zura ngushtë, sepse e dija se çfarë kanë bërë me poetët e tjerë. Dija për ata që e kishin kundërshtuar regjimin... dhe pa u

matur shumë mora një çantë, ca libra dhe më shkoi mendja për të kaluar klonin dhe kalova në Jugosllavi. Ishte diçka që nuk kam shumë qejf ta sjellë ndërmend, se nuk e di... Ishte diçka më e thellë se loti, e unë nuk qaja dot...

- *Ishit vetëm kur ikët?*

- Isha me një shokun tim. Vëllai i tij kishte ikur para dy-tre javësh dhe ai i dinte rrugët më mirë se unë. Pra, për mua ishte diçka shumë e vështirë. Si do që të jetë puna, të ikësh nga atdheu është diçka e vështirë. Nuk mund ta riprodhojë dot në mendjen time atë ndjenjë që kam pasur kur po ngjitesha malit natën. Kështu që i hutuar, i trembur, i zhgënjyer, i lodhur, plot dhimbje, nuk e dija se ç'po merrja me vete dhe se ç'po lija pas.

- *Dhe qëndruat....?*

- Qëndruam në Podgoricë përreth nja dy javë. Pastaj na çuan në Beograd. Aty na futën në një lloj burgu, por ishte diçka ndryshe nga burgu i vërtetë, sepse aty po na mbanin ne që kishim kaluar kufirin dhe po na investigonin; nga kishim ardhur, pse kishim ardhur dhe kush jemi. Për pak kohë, pasi na liruan, unë u vendosa në Beograd në një hotel. Kur erdhi koha që unë të ikja në Amerikë shkova tek Ambasadori Amerikan për intervistën e zakonshme dhe ai më tha "Ju paskeni bashkëpunuar në Shqipëri me disa gazeta dhe keni botuar poezi tek gazetatat më me famë në Shqipëri, tek "Drita", etj. Nuk e kuptoj se çfarë ju ka bërë komunizmi. Si doni të ikni prej komunizmit. Ç'prova keni se e urreni komunizmin?" Unë nuk dija se ç't'i thosha për prova, sepse s'e dija se ç'donte të thoshte me "prova". Megjithatë i thashë se nuk dua të jem deklarativ, por kam një poezi, poezinë që më solli deri këtu. "Këtu në Beograd e ke, më tha". "-Po". "Me vete?" "-Jo. i thashë, e kam në hotel". "- Atëherë në rregull, më tha, sille nesër". Për mua ishte shumë e vështirë të rrija dhe një ditë tjetër vetëm që të çoja atë poezi. Shkova ditën tjetër, ia lexoi përkthyesi dhe ai më tha "Paç fat në Amerikë,bir!". Kjo ishte fjala që shoqëroi udhëtimin tim drejt Amerikës.

- *Gjekë Marinaj në Amerikë...?*

- Oh, në Amerikë e nisa me vështirësi si të gjithë të tjerët. Kur shkova, gjuhën nuk e flisja. Unë vija nga fshatrat e Shqipërisë me një kulturë minimale, pavarësisht se dëshirat e mia për njohuritë jashtëshkollore ishin të mëdha. Fillova të punoj si një punëtor i thjeshtë në një hotel, dhe më duhej që të rregulloj krevatet e të pastroj gjithë shkallën e hotelit. Mirëpo më duhej që të rregulloja 17 dhoma në ditë. Unë nuk kisha aftësi të vendosja aq

rregull dhe nganjëherë më duhej të vija dorën në mes të krevatit dhe të kërceja në anën tjetër në vend, që të mos harxhoja kohë duke u sjellë rrotull. Po ata e panë se unë s'e bëja dot këtë punë dhe për dy javë më dhanë një detyrë tjetër që ishte pak më e lehtë. Duhej të çoja jastëk, ose sende të tjera klientëve kur ata i porosisnin ato dhe kështu punova për pak kohë. Pastaj e ndjeva se nuk doja të jetoja gjithmonë ashtu. Shkova dhe u regjistrova në shkollë. Vazhdova një institut mjekësor që në fakt e mbarova për tre vjet dhe fillova të punoj në një spital si specialist i enëve të gjakut dhe që andej shkova në një kolegji dhe mbarova shkencat e përgjithshme. Sapo mbarova shkencat e përgjithshme, shkova në universitet, në UTD, në Dallas të Teksasit. Aty mbarova artet dhe letërsinë botërore dhe jam akoma në vazhdimësi duke shpresuar që një ditë të fitoj një P.h.d (doktoraturë) në Letërsi. Kam pesë vjet që punoj si pedagog i Letërsisë Botërore dhe i Komunikimit në anglisht në Richland College.

- *Gjekë, keni krijuar familje atje në Amerikë?*

- Kam një grua të mrekullueshme. E ka emrin Dusita dhe ajo ka mbaruar dy universitete. Madje para dy javësh kishim inaugurimin e diplomimit të saj për mjekësi. Fëmijë nuk kemi, se kemi qenë të dy në shkollë, por kemi ndërmend që "të mblidhemi bashkë" dhe të bëjmë diçka... (Qesh).